



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/93
Datë: 13.11.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 nëntor 2009, mori

V E N D I M

1. Miratohen ekstraktet e procesverbaleve dhe transkriptet nga mbledhjet; 91, 92 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/93

Datë: 13.11.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 nëntor 2009, mori

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej 100,000 (njëqindmijë) euro për financimin e projekteve në fshatra multietnike, të përshkruara në Memorandumin e Bashkëpunimit në mes Zyrës së Kryeministrit dhe USAID-it.
2. Mjetet financiare sipas pikës 1. të këtij vendimi ndahen nga rezervat - Shpenzimet e Paparashikuara, kodi 232 - 131, dhe barten në Zyrën e Kryeministrit, programi - Zyra për Komunitete, kodi 15 600.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe Zyra e Kryeministrit.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/93

Datë: 13.11.2009

Kosovës, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës Nr 01/2007, dhe nenit 18, paragrafi 1. të Ligjit mbi Partneritetet Publiko-Private dhe Koncesione në Infrastrukturë dhe Procedurat për Dhënien e Tyre Nr. 03/L- 090, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur në 13 nëntor 2009, mori

V E N D I M

Për koncesionimin dhe zhvillimin me investime private për Hidrocentralet e Vogla të identifikuar në Studimin për Identifikimin e Potencialeve të Resurseve Ujore për Zhvillimin e Kapaciteteve të Hidrocentraleve të Vogla

1. Ministria e Energjisë dhe Minierave dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në bashkëpunim, të përgatisin studimet paraprake të nevojshme për hidrocentralet e vogla që do të jepen me koncesion, bazuar në nenin 18 të Ligjit numër Nr. 03/L - 090, mbi Partneritetet Publiko-Private dhe Koncesionet në Infrastrukturë dhe Procedurat për Dhënien e Tyre.
2. Komisioni Drejtues Ndërmintrosor për Partneritetet Publiko-Private, i themeluar në bazë nenit 11, të Ligjit Nr. 03/L- 090, do të ketë për detyrë përgatitjen dhe zbatimin e procedurave për dhënien me koncesion të hidrocentraleve të vogla. Ky komitet përbëhet nga:
 - 2.1 Ministria e Ekonomisë dhe Financave (kryesues);
 - 2.2 Ministria e Tregtisë dhe Industrisë;
 - 2.3 Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;
 - 2.4 Ministria e Energjisë dhe Minierave;
 - 2.5 Përfaqësues nga Zyra e Kryeministrit.
3. Komisioni Ndërmintrosor për Partneritetet Publiko-Private do të përcaktojë Autoritetin Kontraktues dhe ka autorizimin ligjor për hyrjen në koncesion.
4. Ministria e Energjisë dhe Minierave dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave caktojnë ekipin e ekspertëve me qëllim të përgatitjes së të gjithë dokumentacionit

të domosdoshëm për themelimin e Njesisë për Menaxhimin e Projekteve të Hidrocentraleve të Vogla. Ministria e Ekonomisë dhe Financave planifikon dhe parashikon buxhetin e nevojshëm për operimin e Njesisë për implementimin e projekteve të Hidrocentraleve të Vogla. Deri në atë kohë Njësia për Partneritet Publiko Privat do të shërbejë si Sekretariat i Komitetit Drejtues Ndërministror.

5. Ngarkohen anëtarët e Komitetit Ndërministror për zbatimin e këtij vendimi.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/93

Datë: 13.11.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 nëntor 2009, mori

V E N D I M

1. Miratohet Strategjia e Transportit Multimodal dhe Plani i Veprimit.
2. Ngarkohet Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/93

Datë: 13.11.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 nëntor 2009, mori

V E N D I M

1. Miratohet Strategjia Kosovare për Rini dhe Plani i Veprimit 2010 - 2012.
2. Me qëllim të përmbushjes së objektivave të përcaktuara në këtë strategji, themelohet Komitetit Ndërministror në këtë përbërje:
 - 2.1 Kryeministri i Kosovës - kryesues;
 - 2.2 Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale;
 - 2.3 Ministri i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
 - 2.4 Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë;
 - 2.5 Ministri i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve;
 - 2.6 Ministri i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal;
 - 2.7 Ministri i Ministrisë së Kthimit dhe Komuniteteve;
 - 2.8 Ministri i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave;
 - 2.9 Ministri i Ministrisë së Drejtësisë;
 - 2.10 Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme.
3. Komiteti, sipas pikës 2. të këtij vendimi, do të zhvillojë takime periodike dhe do të angazhohet në ofrimin e këshillave dhe veprimeve konkrete për zbatimin e Strategjisë Kosovare dhe Planit të Veprimit për Rini.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/93

Datë: 13.11.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 nëntor 2009, mori

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej 35.000 (tridhjetepesëmijë) euro për realizimin e filmave dokumentarë sipas projektit të ofruar nga "RexFilm Entertainment" Prishtinë.
2. Mjetet financiare, sipas pikës 1. të këtij vendimi, do të ndahen në mënyrë proporcionale nga Zyra e Kryeministrit, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit 11.667 euro (njëmbëdhjetëmijegjashtëqindëgjashtëdhjeteshtatë euro), secila, dhe barten në llogarinë bankare të produksionit filmik "RexFilm Entertainment" Nr. 1110265142000139 ProCredit Bank.
3. Obligohet Zyra e Kryeministrit, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit që, brenda afatit 3 (tre) ditor nga nënshkrimi i këtij vendimi, ta njoftojnë Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave se nga cilat kode buxhetore të ndahen mjetet financiare.
4. Ngarkohet Zyra e Kryeministrit, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë